



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

---

## KUVENDI I KOMUNËS PEJË

- Komiteti Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit.-

Numër: 01-060/01-45540

Pejë, datë: 19.06. 2024.

### PROCESVERBAL

Nga takimi i V-të i rregullt i Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit të KK Pejë, i mbajtur me datë: 19. Qershor 2024, me fillim në orën 13:00 h.

Takimi u mbajt në Zyren e KPF-ca të KK. Pejë.

Takimin e hapi dhe e kryesoi, kryesuesja znj. Valbona Avdijaj.

Kryesuesja, fillimisht konstatoi se në takim prezantojnë të 5 (pes) nga 7 (shtat) anëtarët e Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Ambientit, mungojn me arsye: z. Addhe Krasniqi dhe z. Adnan Daciq.

Pos anëtarëve të KKMM. prezenton: z.Nysret Hajrizi, drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Pejës.

Pas konstatimit se ekziston kuorumi për mbajtjen e takimit, ngase në takim prezantojnë shumica e anëtarëve të KKMM.-sit, kryesuesja znj. Valbone Avdijaj, hapi takimin e KKMM. dhe për këtë takim propozoi dhe nga të pranishmit njëzërit pa vërëjtje, u miratu ky

### REND DITE :

- 1) Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të Komitetit Këshilëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe mungesat.
- 2) Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi i IV- të i rregullt i Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit, mbajtur me datë: 27. Prill 2024.
- 3) Shqyrtimi i Planit të Veprimit në Mjedisë për periudhën 2024 – 2028.
- 4) Parku “Karagaq”, analiza e gjendjes së gjelbrimit dhe mirëmbajtjes së hapsirave tjera të gjelbëruara në Komunën e Pejës.
- 5) Çështje të ngritur në mbledhje nga udhëheqësi apo anëtarët.

## I.

### **Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të Komitetit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe mungesat.**

Në këtë takim prezentojn 5 (pes) nga 7 (shat) anëtarët e KKMM-it, mungon me arsye: z. Adhe Krasniqi, dhe z. Senad Daciq.

## II.

### **Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi i III-të e rregullt e Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit, i mbajtur me datë: 27. Prill 2024.**

Procesverbali u miratua njëzërit pa vërejtje.

## III.

### **Shqyrtimi i Planit të Veprimit në Mjedisë për periudhën 2024 – 2028.**

Në diskutim lidhur me planin, muarën pjesë:

Z. Nysret Hajrizi, drejtor i DZHE, dhe theksoi se: plani në fjalë është voluminoz dhe gjithëpërfshirës, se është planë që është punuar me përkushtim dhe një kohë bukur të gjatë dhe në bashkëpunim me institucione të ndryshme si psh me organizatën “Era” dhe mëqë bëhet fjalë për projekt ndërkufitar është bashkëpunuar me Malin e zi, e gjithashtu edhe me nivelin ton qendror. Por si projekt i rëndësisë së veçant, duhet bërë përpjekje maksimale nga të gjitha institucionet komunale për realizimin e tij në terësi, kur dihet edhe motoja jonë “Peja vend i gjelbert dhe turistik”. E për implementimin e tij kryesisht duhet të kujdeset Drejtorija për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, bazuar në kompetencat që i ka karshi planit në fjalë.

Z. Ilir Thaçi, anëtarë i komitetit, theksoi se: PLV. i ka kalu procedurat ligjore për miratim dhe implementi. Është miratuar në kuvend dhe ka kalu proceurën e vlerësimit të ligjshmerisë dhe tani ka kalu në fazen kur duhet filluar me implementimin e tij. Për implementimin e këtij plani gjithëpërfshirës, duhet angazhim i të gjitha drejtorive komunale si: DPKSHP, DZHE, dhe drejtorive tjera me përkujdesje të posaqme të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, si drejtori kompetente për përcjelljen dhe implementimin e planit në fjalë.

Pas aprovimit të këtij plani, drejtorit duhet të hartojn planet e veta në implementimin e tij, bazuar në fushëveprimin e vet. Sidomos për planifikimet në mirëmbajtjen e gjelbrimit, mbrojtjen e pyjeve, rregullimin e kanalëzimeve të ujrave të zeza, kanalizimeve për ujitje, për zgjidhjen e problemeve si për çështjen e deponisë etj.

KKMM-sit duhet me qenë aktiv në këtë drejtim të përkrahjes së institucioneve komunale në këtë drejtim.

Znj. Sauda Pantinaj, e znj. Valbona Avdijaj, dhe Fëllënza Podrimçaku Gashi, uruan për planin, si plan voluminoz dhe gjithëpërfshirës dhe shtruan pyetje për drejtorin, se: a ka plane konkrete për mbrojtjen e mjedisit, mbledhjen dhe sistemimin e mbeturinave inerte, plastike, ndarjen e tyre dhe riciklimin, pasrtimin e qytetit, mirëmbajtjen e gjelbrimit, qarkullimin urban, transportin publik,

kufizimet për qarkullimin e mjeteve të transportit me mjete të rënda transportuese, caktimin e rrugëve ku ato mund të qarkullojnë për me mbrojt ambientit dhe infrastrukturës, problemin e parkimit, për zonat e mbrojtura, për zhvillimin e turizmit, për çështjen e Deponisë së f. Svrk etj.

Drejtori, informoi lidhur me pyetjet e shtruar duke theksuar se: është duke u punuar në këtë drejtim që të bëhet sistemimi i mbeturinave dhe riciklimi, por se ende nuk ka rezultate të dukshme në këtë drejtim. Jemi në përpjekje që kjo të rregullohet. Njëkohësisht informoi edhe për planet dhe veprimet tjera si për zgjidhjen e problemeve evidente në mbrojtje të ambientit, për zgjedhjen e problemit të Deponisë në Sverk, ujrave të zeza, kanaleve, problemeve tjera infrastrukturore, pastaj të turizmit, ndërtimin e objekteve si Ziplajneve atraktive për turist, duke potencuar edhe problemet financiare etj.

Nga diskutimet del ky

## **K o n k l u z i o n**

Kërkohet angazhim dhe përkushtim i veçant i Drejtorisë për Ubanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit me subjektet tjera institucionale të Komunës së Pejës, për implementimin e Planit të Veprimit në Mjedisë për periudhën 2024 -2028 .

Obligohen Drejtoritë Komunale që të hartojn planet konkrete për realizimin e PLVM. 2024-2028 bazuar në fushëveprimin dhe përgjegjësin e tyre, me masa konkrete dhe kosto financiare.

Komiteti Komunal për Mbrojtjen e Ambientit të KK.Pejë, do të jetë përkrahës dhe ndihmues në proces të implementimit dhe monitorimit dhe të realizimit të planit të përgjithshëm si dhe në hartim e planeve konkrete dhe implementim e PLVM. nga drejtorit përkatëse.

## **IV.**

### **Parku “Karagaq”, analiza e gjendjes së gjelbrimit dhe mirëmbajtjes së hapsirave tjera të gjelbëruara në Komunën e Pejës.**

Kjo pikë e rendit të ditës nuk u trajtua në mungesë materiali dhe përfaqësimi.

## **V.**

### **Çështje të ngritur në mbledhje nga udheheqësi apo anëtarët.**

#### **Nuk pati çështje të ngritura.**

Mëqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës, e propozime tjera nuk pat, kryesuesja e takimit znj. Valbona Avdijaj, e shpalli të mbyllur këtë takim në orën 15,00 h.

**Pejë, dt.19. Qershor 2024**

**Procesmbajtësi,  
Fëllënza Podrimçaku Gashi**

**Kryesuesja e KKMA.  
Valbona Avdijaj**